



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J


Mbledhjen e gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më **19.10.2020** (e hënë) duke filluar në ora **10:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Shqyrtimi i planit Aksiona Komunal për të zhvendosur dhe kthim të qendrueshëm;
3. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:13.10.2020
Në: Novobërdë



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e pestë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 22.09.2020, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesusi i Kuvendit Nebojsa Arsic, Anëtarët e KPF-së: Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Xhejlane Behluli, Selatin Nuhiu, Drejtori i Financave Sercan Todorovic dhe Kryetarja e Komisionit për dhënje të pronës Komunale në shfrytëzim Slladana Natic.

Kryesuesi pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës duhet konstatuar kuorumin prezentë janë të gjithë antarët e KPF-së pas kësaj e hapi mbledhjen me këtë:

R e n d d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Shqyrtimi i propozim buxhetit për vitin 2021-2023;
3. Shqyrtimi i kërkesave të pranuar për dhënjën në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës;
4. Të ndryshme.

Kryesusi i pyeti të pranishmit se a pajtoheni me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Xhejlane Behluli pasi përshëndeti të pranishmit tha: e kam një kërkesë direkt për Drejtorinë e Financave ku shpresoj se do ta kem perkrahjen e të gjithëve, kerkojm që ta kem listen e të gjithë tatim paguesve dhe të shohim se cilët janë tatim paguesit më të mëdhenje në mënyrë që atje të ju shkojnë investimet. E dim se buxheti më së shumti mbledhet prej të hyrave vetanake dhe këto të hyra të ju kthehen qytetarëve në investime të projekteve. Nuk kam asgjë kundër askujt e as kundër fshatit Llabjan por duhet mi pas prioritet edhe fshatrat tjera se cilat po paguajn më shumë tatim dhe në ato fshatra me i orientu projektet

Kryesuesi e pyeti se a e kërkon këtë listë për këtë mbledhje të Kuvendit?

Xhejlane Behluli tha: nese egziston mundësia me u dergu para buxhetit të Valmirja dhe pastaj Valmirja e percjell tek ne.

Kryesuesi e pyeti Drejtorin e Financave se a mund ta siguroj këtë listë?

Sercan Todorovic tha: se do të biseoj më zyrtarët.

Kryesuesi tha: e kemi këtë propozim të Xhejlanes por mos të hy si pikë në rend dite por te të ndryshmet.

Selatin Nuhiu pasi përshëndeti të pranishmit tha: e kam një vërejtje te pika e tret, nuk duhet të jetë shqyrtimi i kërkesave por raportimi se cilat prona janë dhënë në shfrytëzim dhe cilat nuk janë dhënë.

Xhejlane Behluli tha: ju që jeni pjesë e këtij komisioni a keni raporte?

Kryesuesi tha: ta aprovojme rendin e ditës e pastaj diskutojm me radhë pikat.

Me 4 vota për, 1 apstenim aprovet rendi i ditës nga antarët e KPF-së.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje procesverbali aprovet njëzëri nga të gjithë antarët e KPF-së.

Pika e dytë: Shqyrtimi i propozim buxhetit për vitin 2021-2023;

Kryesuesi për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic pasi pershendeti të pranishmit tha: fillimisht ju kerkoj falje edhe kryesuesit edhe antarëve tjerë që nuk kam arritur me kohë të ju dergoj propozim buxhetin për vitin 2021-2023 as me kohë dhe as sot për arsye të situates që është aktuale, mirëpo ne kemi pranuar një korniz buxhetore në fund të gushtit dhe disa ditë më pas nga Ministria e Financave e kemi marrë një shkresë ku na kanë keruar që ti fillojm proceduart rreth pregaditjes së buxhetit, prap janë dekaruar që për arsye të situates është duhur që të nderpritet ky aktivitet pasi edhe ata kanë bërë ndryshme në korniz dhe kornizen tjetër e kemi pranuar me 15 shtator dhe nga 15 shtatori jemi duke punuar me të gjithë ekipen në pregaditjen e buxhetit për vitin 2021-2023 dhe shpresoj se të premten do të realizojmë dhe do tju dergojm ne form elektronike dhe fizike, andaj po propozoj që kjo pikë të shkoj në Kuvend e besoj se deri në Kuvend do ta merni materialin dhe do të keni kohë që ta analizoni, ju falminderit.

Kryesuesi tha: kerkoj nga ju Drejtor që ta merrni obligimm që përveq formes elektronike ti shperndani dhe tju dergoni secilit antarë të Kuvendit edhe në formë fizike.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: mua kjo punë po më duket jo serioze, nuk e di a është faji i Komunës apo në nivel qendror, është hapsirë e vogel që të analizohet buxheti, ne e kemi mbledhjen me 30 shtator, mendoj se është duhur që të mbahen debate me qytetarë, e di që është koha e pandemisë por është duhur që të gjendet ndonjë zgjidhje

Pasi nuk pati diskutime tjera me me 4 vota për, 1 apstenim aprovohet kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

Pika e tretë: Shqyrtimi i kerkesave të pranuara për dhënjën në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi tha: kjo pikë ka ardhur nga zyra e Kryetarit kështu siç është në rend dite, për këtë pikë ja kaloj fjalën Kryetares së këtij komision Slladana Natic.

Slladana Natic pasi pershendeti të pranishmit tha: komisioni dje ka pasur takim, kemi një numer të konsiderueshem të kerkesave që nga viti 2018 për marrje në shfytëzim të pronës komunale. Dje komisioni është i informuar me të gjitha kerkesat e qytetarëve, mirëpo për fat të keq komisioni i ka pasur duart e lidhura dhe nuk ka pasur mundësi që të merr ndonjë hap për me tutje për arsye të udhëzimit administrativ të ri. Nga muaji gusht në bazë të udhëzimit administrativ të ri që ka hy në fuqi e në këtë rregullore pra është neni 6 ku është e sqaruar detalisht se si janë procedurat që duhet ti ndermarim si komision dhe si komunë që të mundë të japim një pronë në shfrytëzim. Ne si komision si kemi marrë këta hapa që janë sipas ligjit dhe skemi mundur tju pergjigjemi asnjë kerkese të asnjë qytetari. Sipas informatave që kemi marr dje as zyrtari i cili e ka për obligim që ta regjistroj pronën Komunale nuk e ka kryer ende punën e vet prandaj as Kryetari nuk ka pasur mundësi që ta dergoj një pjesë të listes në shqyrtim të Kuvendi. E keni parë edhe raportin e auditorit dhe për çdo vit po perseritet i njeiti problem apo e njeita punë e moskryer se nuk i kemi shqyrtuar kerkesat në Kuvend për dhënjë të pronës komunale në shfrytëzim. Ne si komision i ri dhe unë në krye të këtij komisioni po ju them se gjatë këtyre dy muajve të fundit kemi filluar të punohet më intensivisht fillimisht në regjistrimin e pasurisë andaj shpresoj se deri në fund të vitit ne si komision do të kryejm pjesen tonë të punës, ja dergojm Kyetarit raportin për punën tonë e pastaj Kryetari i drejtohet Kuvendit. Unë e kam raportin e komisionit të kaluar dhe atë raport do tju dergoj për Kuvend.

Xhejlane Behluli tha: unë vetem po e pergëzoj që si Kryetare po merr pjesë dhe po na jep informacione, fatkeqësisht tjerat komisione nuk janë duke funksionuar, unë ju kisha lut vetem të bashkpunoni dhe ta perfundoni punën deri në fund vit ashtu siç është më së miri.

Mirjana Simijonovic pasi pershendeti të pranishmit tha: ne si komision jemi formuar në vitin 2018 mirëpo mbledhjen e parë e kemi pasur në shkurt të këtij viti gjegjësit një muaj para pandemisë, mundë të them se që nga 2018 kemi funksionuar me këtë Kuvend dhe asnjëherë nuk kemi pranuar ndonjë list nga Kryetari që të shohim se cila është pasuria e patundshme e Komunës. Tash po punohet intensivisht nga Kryetarja e komisionit që ajo listë e pasurisë së patundshme të sigurohet, në anen tjetër i kemi qytetarët të cilit kanë parashtruar kerkes por ende skan marr pergjigje dhe po e fajtesojn komisionin që nuk e kan kryer punen e vet, sikur ta kishem marr në çdo funvit listen e patundshme të pasurisë së Komunës dhe listen e kerkesave të qytetarëve.

Kryesuesi tha: duke pas parasysh se e kemi këtë udhëzimin administrativ të ri, ku detalisht ceket se si duhet të ipet pasuria e patundshme Komunale në shfrytëzim në nenin 6 thuhet qartë se Kryetari në bazë të listës së pregaditur të pasurisë së patundshme të Komunës i propozon Kuvendit që të jep një leje preliminare për tu shpallur tenderi që të ipet ajo pronë në shfrytëzim, prandaj prap po them deri sa mos të bëhet regjistrimi i pasurisë dhe Kryetari ti paraqes kërkesë Kuvendit që ta jep lejen preliminare. Është edhe një risi në udhëzim administrativ, ku i kemi edhe dy komisioni, njeri komisioni e bënë vlersimin e asaj prone dhe komisioni i fundit është komisioni që i pranon ankesat, andaj propozoj që kjo pikë të anulohet të shtyhet për muajin tetor pasi që nuk e kemi listen e pasurisë së Komunës si dhe nese kemi ende ndonjë paqartësi mundë të kërkojmë prej Ministrisë ose OSBE-së që të organizojn trajnime në mënyrë që të informohemi më shumë lidhur me këtë qështje.

Mirjana Simijonovic tha: është një paqartësi pasi që një zyrtarë e ka marrë token në shfrytëzim për 15 vite tash e ka perserit kërkesen në bazë të ligjit të ri që ka të drejt me ju vazhdu kontrata dhe po e kërkon për 30 vite.

Kryesuesi tha: nuk kemi që të votojm më shumë për këtë pikë e vendosem ta shtyjm për muajin tetor.

Pika e katërt: Të ndryshme.

Kryesuesi tha: për arsye të buxhetit mbledhjen e kuvendit po e bartim me datë 29 shtator, në mënyrë që të kemi kohë ta pregadisimi materialin dhe ta dergojm në Ministri.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.
Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

Procesëmbajtëse
Valmire Mustafa



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic

